



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

Nr. 53 Prot.

Tiranë, më 15.01.2021

UDHËZIM

Nr. 1, datë 15.01.2021

PËR MARRJEN E AMBJENTEVE ME QIRA NGA ZYRAT RAJONALE
STATISTIKORE

Në kuadër të disiplinimit të procedurës së marrjes së ambjenteve me qira bazuar në Ligjin Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare"

UDHËZOJ

1. Në varësi të nevojave që ka, zyra rajonale statistikore të përcaktojë saktë kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojë një ambjent për zyrë të përshtatshme pune.
2. Procedura e gjetjes së ambjentit fillon me kërkesën e veçantë të përgjegjësit të zyrës përkatëse rajonale statistikore drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT.
3. Bazuar në kërkesën paraprake të përgjegjësit të zyrës përkatëse rajonale, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it ngre një komision ad-hoc, i cili, pasi kryen një analizë tregu për të parë çmimet referencë në zona të ndryshme të qytetit, harton procesverbalin e vlerësimit në bazë të rezultateve të dala nga kjo analizë, duke përcaktuar ambjentet që përmbushin kushtet e kriteret e paracaktuara.
4. Propozimi i komisionit për klasifikimin e ofertave të qirasë, i dërgohet për miratim Drejtorit të Përgjithshëm të INSTAT-it, nëpërmjet përgjegjësit të zyrës rajonale përkatëse.
5. Sektori i Prokurimeve pranë Drejtorisë së Financës dhe Projekteve kontrollon dhe përgatit praktikën e marrjes së ambjentit me qira të përcjellë nga përgjegjësi i zyrës rajonale statistikore dhe e paraqet për miratim tek Drejtori i Përgjithshëm.
6. Pas dhënies së miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT-it, përgjegjësi i zyrës rajonale statistikore është i autorizuar të nënshkruajë kontratën e qirasë me subjektin ofertues të përzgjedhur.
7. Akti për marrjen e ambjenteve me qira me qëllim përdorimi si zyrë rajonale statistikore duhet të përmbajë objektin që merret në përdorim, përshkrimin e tij, shkakun ligjor, afatin dhe masën e shpërblimit përkatës.
8. Kosto e marrjes me qira të zyrës duhet të jetë ekonomikisht e leverdisshme dhe nuk duhet të kalojë vlerën e parashikuar për këtë zë në buxhetin vjetor të zyrës.

INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vlazen Huta", Nd. 35, H1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 228300

www.instat.gov.al / info@instat.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I STATISTIKAVE

9. Procedurat e nisura para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi të vazhdojnë të ndjekin udhëzimin nr. 61 prot., datë 17.01.2014 "Për procedurën e marrjes së ambjenteve me qira".
10. Moszbatimi i këtij udhëzimi nga personat e ngarkuar, përbën shkelje administrative dhe ndaj tyre merret masë disiplinore në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
11. Ngarkohen përgjegjësit e zyrave rajonale statistikore për ndjekjen e zbatimit të këtij udhëzimi.
12. Ngarkohet Zyra e protokollit për shpërndarjen e këtij udhëzimi për dijeni tek të gjitha zyrat rajonale statistikore të INSTAT dhe Sektorit të Prokurimeve/Drejtorisë së Financës dhe Projekteve.
13. Ky udhëzim zëvendëson udhëzimin nr. 61 prot., datë 17.01.2014 "Për procedurën e marrjes së ambjenteve me qira".
14. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
ELSA DHULI



INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. "Vlazen Huta", Nd. 35, H1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017, Tirana, ALBANIA,
Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300
www.instat.gov.al / info@instat.gov.al